



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

RRITJA EKONOMIKE

KONFERENCA E PËRBASHKËT E OECD

MINISTERIALI NË SAMITIN E POZAN

MARRËVESHJA NË SAMITIN E POZAN

ANALIZA 6 MUJORE E ADMINISTRATES TATIMORE

RRITJA E EKSPORTEVE TE USHQIMEVE DHE PIJEVE

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS

DITARI JAVOR

1-7 Korrik 2019



INSTAT publikoi rritjen ekonomike të tremujorit të parë të këtij viti që rezultoi brenda pritshmërive, ku sektorët kryesorë të ekonomisë kanë treguar një rritje të kënaqshme. Disa sektorë si energjia dhe argëtimet pësuan një tkurrje, që më shumë vjen si një rezultat i efektetit sezonal të thatësirës së fillimvitit, duke zbutur kontributin e tremujorit të parë në rritjen vjetore. Ministria Denaj në një dalje për mediat, u shpreh se, efektet negative në tregun e lojrave të fatit, që patën ndikim në 3-mujorin e parë është një kosto që e kemi përlogaritur sepse të mirat sociale janë shumë më të mëdha dhe në afatgjatë do të përkthehet edhe në përfitim ekonomik. Ndërkohë punësimi është rritur me 1.5% (ose rreth 17.8 mijë të punësuar më tepër) se 3-mujori i parë i 2018, papunësia është ulur në 12.1%, besimi te bizneset dhe konsumatori është rritur sikurse dhe investimet e huaja direkte krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (1.6% rritje).



U mbajt në Poznan, të Polonisë, Konferenca e Përbashkët OECD- Poloni "Mbi Potencialin e Transformimit të Evropës Juglindore" e cila është pjesë e Samitit të Poznan dhe Axhendës së Ministrave të Ekonomisë të Ballkanit Perëndimor, ku mori pjesë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj. Në fjalën e saj, Ministria Denaj, theksoi rëndësinë që ka tregtia dhe investimet si dy elementë thelbësorë të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Angazhimi i qeverisë është që këto investime në të ardhmen e afërt të orientohen drejt sektorëve të tjerë, po ashtu prioritarë, në përpjekje për të zhvendosur ekonominë nga një model tradicional drejt një modeli gjithmonë e më inovativ, me sektorë dhe industri të reja.



Takimi i Ministrave të Ekonomisë të Ballkanit Perëndimor u përqendrua në nxitjen e diskutimeve mbi ecurinë dhe progresin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit (MAP) për Zonën Ekonomike Rajonale (REA), agjendës së ndërlidhjes mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integritimit më të fortë të ekonomive të rajonit edhe në zinxhirët e vlerave në të gjithë Evropën. Në cilësinë e vendit Kryetar të CEFTA-s, në emër të Shqipërisë, Ministria Denaj, shprehu gatishmërinë ndaj një qasjeje që i shërben zgjidhjes së divergjencave ekonomike dhe politike brenda ekonomive tona, si një domosdoshmëri për të patur një Zonë Ekonomike Rajonale funksionale në të ardhmen, me dëshirën për të qënë pjesë integrale e familjes Evropiane.



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Europiane të Investimeve (BEI), Z. Luca Lazzaroli, nënshkruan Marrëveshjen për financimin e një shume prej 10.4 mln euro për projektin "Vazhdimi i Bulevardit Gjergj Fishta dhe Bajram Curri dhe Rehabilitimi i Lumit të Lanës nga Ura Teknologjike deri tek Kryqëzimi me Rugën Teodor Keko". Projekti, që do të zbatohet nga Bashkia e Tiranës deri në Shkurt 2022, parashikon udhëzimin e Lumit të Lanës duke krijuar një shtrat me regjim hidraulik eficient për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë duke krijuar kështu hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës përmes ndërtimit të të gjithë infrastrukturës së nevojshme, çka synon dhe tërheqjen e investitorëve vendas dhe të huaj.



Ministria Anila Denaj mori pjesë në analizën 6 mujore të Administratës Tatimore, ku janë analizuar rezultatet për çdo rajon si dhe arsyet në mos realizimin e të ardhurave. Gjithashtu gjatë këtyre takimeve u vendosen objektivat dhe kriteret e performancës për çdo drejtori rajonale për 6 mujorin e dytë të vitit, ku secila prej tyre në bashkëpunim me Hetimin Tatimor, një strukturë e rifortuar e gjitha, miratuan planet operacionale dhe sektoriale për të realizuar objektivin institucional dhe ulur informalitetin.



Ministria Denaj zhvilloi një vizitë në mjediset e kompanisë "Kraco", prodhimet e së cilës gjenden në shumë tregje evropiane. Ministria theksoi se eksportet në Shqipëri përbëjnë një potencial shumë të madh zhvillimi ekonomik, rritje punësimi, por edhe prezantim shumë i mirë i Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare. Suporti ndaj sipërmarrësve shqiptarë për t'i bërë produktet shqiptare gjerësisht të njohura, por dhe për të nxitur investimet e reja në funksion të rritjes së konkurrueshmërisë në produkte do të jetë në fokus të qeverisë shqiptare. Eksportet në zërin e ushqimeve dhe pijeve u rritën me 17.8% gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2019, krahasuar me një vit më parë.



580 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 01-04 korrik 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e kanë Qarku i Tiranës dhe Durrësit me nga 142 persona, ndjekur nga Qarku i Vlorës me 87 persona, i Shkodrës me 55 persona, i Korçës me 43 persona, i Fierit me 38 persona, i Elbasanit me 16 persona, i Lezhës me 16 persona, i Beratit me 13 persona, i Dibërës me 12 persona, i Kukësit me 10 persona dhe Qarku i Gjirokastrës me 6 persona.